



KOMISIONI EUROPIAN

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR KËRKIM & INOVACION

Njoftuar më OJ C342/03 22 Nëntor 2013

Thirrje drejtuar individëve studiues për krijimin e një **Baze të Dhënash të Ekspertëve të ardhshëm të Pavarur për të asistuar Komisionin European lidhur me** vlerësimin e projekt-propozimeve që paraqiten në kuadër të Programit të BE **me Horizon 2020 - Programi Kuadër për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin(2014-2020)**.

1. Komisioni European fton individë studiues të fushave të ndryshme që të aplikojnë e shprehin interesin e tyre për të qenë pjesë e të një **Baze të Dhënash me Ekspertë të Pavarur të cilët mund të kontraktohen nga Komisioni Eurioopian lidhur me** vlerësimin e projekt-propozimeve që paraqiten në kuadër të Programeve të mëposhtme:

- Horizon 2020 - Programi Kuadër për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (2014-2020) dhe programet e tij specifik (Horizon 2020 Programi kuadër), dhe
- Programin e Kërkimit Shkencor dhe Trajnimit të Komunitetit të Energjisë Atomike Evropiane (2014-2018) që plotëson Programin Horizon 2020 - Programi Kuadër për Kërkim dhe Inovacioni ("Programit Euratom"), (kolektivisht "Horizon 2020"), dhe
- Fondin e Kërkimit për Qymyrin dhe Celikun (RFCs),

2. Në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara lidhur me rregullat për pjesëmarrjen dhe shpalljen e rezultateve të projekt-propozimeve që paraqiten në kuadër të "Horizon 2020 - Programi Kuadër për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (2014-2020)", Komisioni European dhe strukturat financuese mund të caktojnë ekspertë të pavarur për ti këshilluar ose ndihmuar lidhur me:

- (a) vlerësimin e projekt-propozimeve;
- (b) monitorimin e zbatimit të projekteve të financuara nën programin Horizon 2020, qoftë nga kërkimet shkencore të mëparshme dhe / ose programeve të Inovacionit;
- (c) zbatimin e politikës së kërkimit shkencor dhe inovacionit të BE-se ose programeve duke përfshirë Horizon 2020 si edhe arritjet për funksionimin e Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor- ERA;
- (d) vlerësimin e Programeve të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
- (e) projektimin e politikës së kërkimit shkencor dhe inovacionit të BE-se, duke përfshirë përgatitjen e programeve të ardhshme.

3. Për këtë qëllim, Komisioni Europian fton individët studiues për të aplikuar si ekspertë të ardhshëm të pavarur nëpërmjet "Portalit të Pjesëmarrësit" në mënyrë që të përfshihen në regjistrin e ekspertëve.

Megjithatë, Komisioni Europian ose struktura përkatëse e financimit të këtyre projekteve nëse konsiderohet e përshtatshme dhe në raste të justifikuara, nuk është i detyruar të caktojë vetëm ekspertët e regjistruar në këtë bazë të dhënash. Ajo mund të përzgjedhë në mënyrë transparente individë ekspertë të fushave të ndryshme të kërkimit shkencor që kanë aftësitë e duhura por që nuk janë të përfshira në bazën e të dhënave,

Komisioni Europian ose struktura përkatëse e financimit të këtyre projekteve mund të kërkojë këshillën e organeve të caktuara për emërimin e ekspertëve të pavarur.

Në rastin e granteve kërkimore individuale të ERC- European Research Council- Këshilli Europian i Kërkimit Shkencor , ekspertët do të emërohen në bazë të propozimit të këtij Këshilli.

4. Ekspertët e pavarur që aplikojnë për të qenë pjesë e kësaj Baze të Dhënash Ekspertësh do të zgjidhen në bazë të aftësive, përvojës dhe njohurive të duhura për të kryer detyrat e caktuara për ta. Ekspertët e ardhshëm të pavarur duhet të kenë një nivel të lartë përvoja profesionale në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme, që lidhen me aspekte të ndryshme të kërkimit shkencor të Programit të BE Horizon 2020 - Programi Kuadër për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin(2014-2020):

- Grantet Individuale të Këshillit Evropian i Kërkimit Shkencor;
- Teknologjitë e reja dhe të së ardhmes;
- Aksionet Marie Skłodowska-Curie në aftësim, trajnim dhe zhvillim të karrierës;
- Infrastruktura kërkimore (përfshirë e-infrastruktura);
- Lidërsip i aftë dhe teknologjitë industriale:
 - Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit;
 - Nanoteknologjitë;
 - Materialet e përparuara;
 - Bioteknologjitë;
 - Prodhim dhe përpunim i avancuar;
 - Hapësira;
- Aksesimi në financime;
- Inovacioni në SME-të (Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla);
- Shëndetësia, ndryshimi demografik dhe mirëqenia;
- Siguria e ushqimit, bujqësia dhe pylltaria e qëndrueshme, kërkimet ujore, detare dhe të ujërave të brendshme dhe bio-ekonomia;
- Energji e sigurtë, e pastër dhe efiçente;
- Transport inteligjent, i gjelbër dhe i integruar;
- Veprimi i klimës, efiçasiteti i burimeve dhe lëndëve të para;
- Europa në një Botë në ndryshim – shoqëritë gjithëpërfshirëse, të reja dhe reflektuese;
- Shoqëritë e Sigurta – mbrojtja e lirisë dhe sigurisë së Europës dhe qytetarëve të saj;
- Përhapja ekselencës dhe zgjerimi i pjesëmarrjes;
- Shkenca me dhe për shoqërinë.

Gjithashtu ka nevojë për ekspertë që mbulojnë fusha të tilla si:

- Bashkëpunimi ndërkombëtar në shkencë dhe teknologji;
- Administrimi, menaxhimi apo vlerësimi i projekteve të kërkimit dhe inovacionit, programet ose politikat lidhur me to,
- Inovacioni (teknologjik, si dhe ai jo-teknologjik), duke përfshirë inovacionin social, proceset e inovacionit dhe menaxhimin,
- Menaxhimin e biznesit, me ekspertizë në menaxhimin e produktit/shërbimit, marketingut, investimeve dhe instrumenteve financiare (p.sh. kapitalit dhe financimit të borxhit), etj veçanërisht në lidhje me SME-te inovative,
- Përdorimi i rezultateve të projekteve të kërkimit dhe inovacionit, përhapjen e transferimit të njohurive, dhe të drejtat e pronësisë intelektuale,
- Shkencat socio-ekonomike dhe humane, duke përfshirë ndikimin shoqëror dhe ekonomik dhe vlerësimin e riskut,
- Kërkim dhe inovacion i përgjegjshëm, duke përfshirë angazhimin publik, edukimin shkencor,
- Barazia gjinore dhe përbërja gjinore e kërkimit,
- Zhvillimi i karrierës në kërkim, trajnimet e doktoraturës dhe rritjen e aftësive,
- Etika në kërkim (psh mbrojtja e njeriut, përfshirja e fëmijëve/popullatave vulnerable, mbrojtja e të dhënave, mirëqenia e kafshëve, mbrojtja e mjedisit, bashkëpunimi ndërkombëtar, keqpërdorimi/përdorimi keqdashës, integriteti i kërkimit, etj),
- Monitorimi i programeve dhe vlerësimi,
- Politikat e kërkimit dhe inovacionit,
- Zhvillimi i qëndrueshëm,
- Komunikimi.

Ekspertët e pavarur duhet të kenë njohuritë dhe aftësitë e duhura të gjuhës angleze lidhur me detyrat që duhet të kryejnë.

5. Të gjitha kontaktet me ekspertët e pavarur, duke përfshirë nënshkrimin e kontratave dhe çdo ndryshim i tyre, do të kryhen nëpërmjet sistemit të platformës on-line të shkëmbimit të informacionit siç përcaktohet nën 287 (4) të Rregullores së Deleguar të Komisionit (BE) Nr1268/20123.

Duke dërguar aplikimin e tyre nëpërmjet adresës së internetit , përmendur në paragrafin 6, ekspertët e pavarur bien dakord të përdorin sistemin e shkëmbimit elektronik të informacionit për të komunikuar me Komisionin European ose strukturën përkatëse të financimit të projekt-propozimeve të caktuara. I tërë komunikimi i bërë përmes sistemit të shkëmbimit elektronik (duke përfshirë nënshkrimin e kontratës, ndryshimet, njoftimet, kërkesën për pagesën, etj) konsiderohet i barabartë me dokument në letër, do të jetë i pranueshëm si dëshmi në procedura ligjore, do të konsiderohet si origjinal i dokumentit dhe gëzon prezumimin ligjor të autenticitetit dhe integritetit, me kusht që të mos përmbajë ndonjë veçori dinamike të aftë për të ndryshuar automatikisht atë. Nënshkrimet elektronike do të kenë të njëjtin efekt ligjor të nënshkrimeve të shkruar me dorë.

6. Aplikimet mund të dorëzohen vetëm nëpërmjet sistemit online të shkëmbimit të informacionit në adresën e mëposhtme të internetit:

<http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/experts>.

Inkurajohet Aplikimi i hershëm, pasi **struktura përkatëse financuese ose Komisioni European do të përdorin** që në fillim të vitit 2014 bazën e të dhënave të ekspertëve të pavarur për seancat e para të vlerësimit të projekt-propozimeve në kuadër të Horizon 2020.

Ekspertët të cilët tashmë janë të regjistruar në bazën e të dhënave të ekspertëve të pavarur që ishte parashikuar për zbatimin e Programit të Shtatë Kuadër- Seventh Framework Programme (2007-2013) por që dëshirojnë të aplikojnë për Programin Horizon 2020(2014-2020), janë të ftuar të hynë në faqen e mësipërme të internetit. Pasi të hynë duhet të deklarojnë interesin e tyre për të qenë pjesë e listës së ekspertëve të pavarur për Horizon 2020, dhe të përditësojnë fushën e tyre të ekspertizës në përputhje me fushat e reja të ekspertëve për H2020 dhe zonat e paracaktuara:

<http://ec.europa.eu/research/participants/portal/page/experts>

Në mënyrë që aplikimet e ekspertëve studiues nga vende të ndryshme të jenë të aksesueshme përsa u përket fushave të kërkimit shkencor ku ata kanë shprehur interes të kontraktohen si vlerësues për Programin Horizon 2020, të gjitha pjesët duhet të përditësohen dhe plotësohen rregullisht. Fushat e ekspertizës të kërkimit të tyre shkencore dhe përvoja profesionale duhet të jenë të detajuara dhe të dokumentuara në mënyrë të përshtatshme. Një aplikim për ekspert vlerësues të projekt-propozimeve të H2020 konsiderohet i plotë pasi të jetë konfirmuar se është i vlefshëm nga sistemi i shkëmbimit elektronik të informacionit (portali përkatës).

Të dhënat personale të mbledhura do të përpunohen në përputhje me Rregulloren (KE) Nr 45/2001 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 18 Dhjetor 2000 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave".

7. Për arsye të transparencës dhe në përputhje me objektivat e Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor - ERA, Komisioni mund të autorizojë që organe publike financuese të kërkimit shkencor nga Shtetet Anëtare dhe vendet e asociuara apo subjekte të ngritura me përfshirjen e BE-së në programe kërkimore të përbashkëta me Shtetet Anëtare të programit Horizon2020, të kenë akses regjistrin e ekspertëve të ardhshëm të pavarur, me kusht që ekspertët e interesuar të kenë dhënë pëlqimin e tyre paraprak në Formularin e Aplikimit.

Emrat e ekspertëve të emëruar në cilësi personale, të cilët kanë asistuar Komisionin Evropian ose organet e tjera të financimit në zbatimin e Programit Kuadër Horizon 2020 do të publikohen së bashku me fushën e tyre të ekspertizës, të paktën një herë në vit në faqen e internetit të Komisionit apo atë të organit kompetent të financimit. Një informacion i tillë do të grumbullohet, përpunohet dhe publikohet në përputhje me Rregulloren (KE) nr 45/20014.

8. Për të siguruar pavarësinë e punës për të cilën ata do të kontraktohen, në cilësinë e tyre si "ekspertë të pavarur", para nënshkrimit të kontratës, atyre do tu kërkohet të dëshmojnë se bien dakord të veprojnë në përputhje me kushtet e kodit të mirësjelljes (duke përfshirë aspektet e konfidencialitetit) në sistemin e shkëmbimit elektronik të informacionit(portalin përkatës). Në veçanti, atyre do tu kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se nuk kanë konflikt interesi në

kohën e kontraktimit dhe që marrin përsipër të informojnë Komisionin ose organin përkatës të financimit nëse ndonjë konflikt interesi lind përgjatë kohës së ushtrimit të detyrave të tyre si ekspertë vlerësues.

Në rastet kur ekspertët e pavarur do të kenë të bëjnë me informacionin të klasifikuar, para emërimit të tyre do të kërkohet certifikata e sigurisë.

9. Komisioni European ose struktura përkatës financuese e projekt-propozimeve të paraqitura duhet të marrë masat e duhura për të patur një përbërje të ekuilibruar brenda grupeve të ekspertëve dhe paneleve të vlerësimit në drejtim të aftësive të ndryshme, përvojës, njohurive, diversitetit gjeografik dhe gjinisë, në varësi të situatës në fushën e veprimit. Kur është e mundur do të kërkohet një raport mes përfaqësuesve nga sektori privat-publik.

10. Komisioni European ose struktura përkatës financuese do të zbatojë mekanizma të përshtatshëm për të siguruar një rotacion të arsyeshëm të ekspertëve të pavarur për vlerësimet nga njëri vit në tjetrin.